

Herolind Limani, MA<sup>1</sup>

UDC: 81`272:340.13(497.7)  
342.725(497.7)

**LIGJI PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE, SQARIMI I DISA DILEMAVE  
DHE I STRUKTURËS SË TË NJËJIT**

**ЗАКОН ЗА УПОТРЕБА НА ЈАЗИЦИТЕ, ПОЈАСНУВАЊЕ НА  
НЕКОИ ДИЛЕМИ И НА СТРУКТУРАТА НА ИСТИОТ**

**LAW ON THE USE OF LANGUAGES, CLARIFICATION OF SEVERAL  
DILEMMAS AND STRUCTURE OF THE SAME**

**Abstract**

Knowing that the framework of the National Legislation in the field of language use with a special focus on the Albanian language in the Republic of North Macedonia is the Law on the Use of Languages, then the focus of this topic will be to answer some general or principle questions in order to clear some dilemmas that critics make to the law: 1) is the Law on the Use of Languages contrary to the Constitution of the Republic of North Macedonia or not; 2) is the Law on the Use of Languages in accordance with international standards; 3) is the Albanian language equating with the Macedonian language as an official language in the Republic according to the Law on the Use of Languages or is it only advanced, continuing with some introductory words regarding the Law on the Use of Languages and to conclude with clarification of the structure of the same.

*Keywords: human rights, use of language, positive legislation, state*

**Kushtetutshmëria e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve**

Pyetja e parë të cilës do t'i përgjigjem është pikërisht kjo, për arsye se kritika kryesore që i është bërë Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve është se ky ligj është jokushtetues. E kam përmendur në disa raste, prapë po e përsëris se, Kushtetuta është një akt i përgjithshëm juridik e cila si e tillë përcakton

---

<sup>1</sup> Inspektor për mbikëqyrjen e përdorimit të gjuhëve në Inspektoratin e Përdorimit të Gjuhëve.

dhe rregullon çështjet më të rëndësishme në shtet, por nuk i rregullon këto çështje apo marrëdhënie në detaje dhe kjo është normale. Tani në rastin konkret, Kushtetuta e RMV-së në nenin 7 të saj përcakton se edhe gjuha e folur nga 20 % e qytetarëve (gjuha shqipe) është gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por siç u shprehëm pak më lart, për ta rregulluar këtë çështje (përdorimin e gjuhës) në mënyrë më të hollësishme, vetë Kushtetuta parashihet nevojën e miratimit të një ligji i cili do të përcaktojë se në cilat sfera dhe si do të përdoret gjuha shqipe si gjuhë zyrtare në RMV. Dhe pikërisht një ligj i këtillë që ka rregulluar këtë materie është miratuar në vitin 2008<sup>2</sup> dhe i njëjti është plotësuar në vitin 2011 dhe unë për aq sa mbaj mend në atë kohë nuk ka pasur debate dhe diskutime në lidhje me atë se ai ligj ka qenë kundërkushtetues, edhe pse shkonte përtej asaj çka parashihte Kushtetuta, ashtu siç shkon edhe ligji aktual, por kjo nuk do të thotë se ligji është antikushtetues, për arsye se një gjë të tillë vetë Kushtetuta e përcakton dhe e kërkon. Më konkretisht, Kushtetuta përsërit katër herë se duhet të miratohet një ligj sipas të cilit do të rregullohet përdorimi i gjuhës shqipe. A një prej atyre dispozitave më të rëndësishme të Kushtetutës është neni 7, parag. 5 ku thekson se: “në organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, gjuha zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase, mund të përdoret në pajtim me ligjin”. Dhe ja ky është pikërisht ai ligj (Ligji për Përdorimin e Gjuhëve dhe ligji i vitit 2008) që parashikon, përcakton dhe kërkon Kushtetuta e RMV-së konform të cilit do të duhet të përdoret dhe aplikohet gjuha shqipe nëpër institucionet shtetërore, procedura, akte si dhe sfera të caktuara.

Me një fjalë, është vetë kushtetutvënësi ai që e ka paraparë të nevojshme miratimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve siç ka paraparë edhe miratimin e shumë ligjeve të tjera që rregullojnë fusha tjera, sepse po të donte ai që çështja e përdorimit të gjuhëve të ngelet vetëm në normë kushtetuese do ta rregullonte vetëm si të tillë. Prandaj është mirë të themi se, kur bëhet fjalë për ligjet që rregullojnë çështjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, “shtrirja, zgjerimi” e/i lirive dhe të drejtave me ligj nuk mund të konsiderohet aspak jokushtetuese. Ajo çka do të ishte më problematike dhe që ekziston në RMV është e kundërta e kësaj, domethënë kufizimi i lirive dhe të drejtave kushtetuese me ligj. Si shembull më të mirë për të ilustruar këtë që përmendëm më lart mund të marrim, “të drejtën e qytetarit për të votuar - të drejtën e votës” që domethënë se për ta fituar këtë të drejtë qytetari, Kushtetuta e RMV-së numëron: personi të ketë shtetësi, të jetë i moshës madhore dhe të mos jetë i privuar nga zotësia e veprimit<sup>3</sup> por jo vetëm kaq sepse Kodi Zgjedhor i RMV-së parashikon kushte shpesh për qytetarët: vendbanim të

<sup>2</sup> Ligji për përdorimin e gjuhës të cilën e flasin 20% e qytetarëve në RM dhe në njësitë e vetadministrimit lokal, “Gazeta zyrtare” e RM-së, 101/08.

<sup>3</sup> Shih: Kushtetuta e RMV-së, neni 22.

përhershëm në RMV dhe letërnjoftim apo pasaportë të vlefshme.<sup>4</sup> Tani edhe pse këto kushte apo kërkesa shtesë të Kodit zgjedhor nuk parashikohen me normën kushtetuese, por në realitet kërkohen, askush nuk i konsideron të njëjtit/at jokushtetues/e. Shembull tjetër i kufizimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese me ligj është edhe “e drejta në privatësi” e cila parashikohet në nenin 25 të Kushtetutës së RMV-së dhe ky nen aspak nuk parashikon mundësinë e kufizimit, ndërsa Ligji për ndjekjen e komunikimeve lejon kufizim të privatësisë dhe askush nuk pretendon se ligji i tillë është kundërkushtetues dhe shembuj të tillë ka shumë.

Prandaj nga e gjithë kjo që cekëm mund të konstatojmë se Ligji për Përdorimin e Gjuhëve nuk është antikushtetues edhe përkaj zërave të tillë, sepse me asnjë dispozitë të tij nuk e atakon Kushtetutën e RMV-së, por përkundrazi silltet në frymën e saj dhe të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Dhe nëse shihet me kujdes, ligji në tërësi është brenda kornizës kushtetuese dhe në disa raste shkon edhe deri në kufi të saj, por nuk e tejkalon atë. Por, mund të theksojmë se Ligji për Përdorimin e Gjuhëve në përmbajtjen e tij normative ka disa dispozita të paqarta, konfuze apo të pasaktësuarra siç duhet për të cilat do të prononcohem më poshtë, por kjo nuk e bënë që ai të jetë jokushtetues. Dhe më saktësisht thënë, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve e konkretizon normën kushtetuese të Amendamentit V të Kushtetutës se në cilat fusha dhe si duhet të përdoret gjuha shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pra bën atë që e kërkon Kushtetuta dhe asgjë më tepër. Pra, me një fjalë, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve nuk e rrezikon në asnjë rast gjuhën maqedonase dhe të drejtat e maqedonasve aspak, gjuha maqedonase vazhdon edhe më tej të mbetet si gjuhë e vetme zyrtare në përdorim të përgjithshëm ndërsa sa i përket gjuhës shqipe, ajo do të zbatohet vetëm brenda atyre sferave që parashikon ligji në fjalë. Këtë më së miri mund ta vërejmë në nenin 1, parag. 3 të ligjit ku thuhet: “Në të gjitha organet e pushtetit shtetëror në RM, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, entet dhe organizatat, komisionet, personat juridik që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet e tjera, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha që e flasin 20 % e qytetarëve të RM-së dhe alfabeti i saj, në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

Siç mund të vërejmë, në të gjitha këto institucione dhe në të gjitha procedurat dhe fushat që ceken në nenin 2 të ligjit, gjuha maqedonase ngelet e paprekur si gjuhë zyrtare, ndërsa gjuha shqipe do të zbatohet së bashku me gjuhën maqedonase vetëm në ato sfera dhe procedura që parasheh ligji dhe jo jashtë tyre. Prandaj mendoj që ligji është brenda kornizave të Kushtetutës dhe se nuk bie ndesh me normën kushtetuese sa i përket gjuhës maqedonase si gjuhë e vetme zyrtare në përdorim të përgjithshëm. Megjithatë, ky është mendimi im personal, por janë organet kompetente ato që do të konstatojnë

<sup>4</sup> Kodi zgjedhor i RMV-së, “Gazeta zyrtare” e RM-së, Nr. 06/40, neni 41, parag. 4.

një gjë të tillë. Dhe tani nëse e lexojmë me kujdes ligjin në fjalë, këtë e ofroj si argument shtesë, ku do të mund të shohim se i njëjti nuk e barazon gjuhën shqipe me atë maqedonase, gjë që do ta bënte të ishte (kundërkushtetues) në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 7 të Kushtetutës por vetëm e zgjeron dhe avancoon përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare konform nevojave të qytetarëve shqiptarë në RMV, gjë të cilën nuk e bënte në shumë sfera ligji i vitit 2008 për përdorimin e gjuhëve. Për më tepër për këtë do të shohim në vazhdim të tekstit.

### **Standardet ndërkombëtare dhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve**

Përmendja e standardeve ndërkombëtare këtu është jo paarsye, sepse te Ligji për Përdorimin e Gjuhëve përdoren dy instrumente ndërkombëtare si burime në hartimin dhe përpilimin e tij. E para është Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare si burim më i përgjithshëm dhe e dyta është Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave si burim më i drejtpërdrejtë ndërkombëtar.

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe për përdorimin gjuhëve (të pakicave) në veçanti janë nivel më i ulët i rregullimit të një çështje përkatësisht përdorimit të gjuhëve në rastin konkret. Apo me fjalë të tjera, Instrumentet ndërkombëtare që u referohen pakicave kombëtare dhe gjuhëve të tyre janë apo krijojnë standard minimal për rregullimin e përdorimit të gjuhëve a kjo mëtej nënkupton se në njërin anë, askush nuk guxon të shkojë nën këto standarde të cilat janë minimale apo janë bazament nga i cili fillohet të rregullohet përdorimi i gjuhëve në rastin konkret, por në anën tjetër, nuk ekziston asnjë pengesë për një shtet që të shkojë mbi dhe jashtë asaj që është e përcaktuar me këto standarde që janë minimale.<sup>5</sup> Dhe ky është një parim i njohur në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Konform kësaj që thamë, nuk ka asnjë pengesë që gjuha shqipe të përdoret si gjuhë zyrtare në RMV, më gjerë se sa që përcaktojnë standardet e këtyra ndërkombëtare. Dhe me këtë ligj, pra me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve kjo edhe ndodh, domethënë rregullimi dhe përdorimi i gjuhës shqipe në RMV shkon më larg apo përtej asaj që përshkruajnë këto standarde në instrumentet ndërkombëtare. Ndërsa tani, këto instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut mund të konsiderohen si standarde të larta apo maksimale vetëm për ato shtete që nuk janë palë, që nuk i njohin apo pranojnë si dhe që nuk kanë vullnet që t'i ratifikojnë dhe me këtë edhe t'i zbatojnë të njëjtit si për shembull për Bullgarinë, Greqinë, Turqinë, Gjeorgjinë, Shqipërinë etj.

<sup>5</sup> Për ta verifikuar më mirë këtë se instrumentet ndërkombëtare janë standard minimal dhe se nuk ka asnjë pengesë nëse shtetet me legjislacionin e brendshëm apo kombëtar shkojnë përtej asaj që përcaktojnë këto instrumente, shih: Nenin 4 të Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave si dhe Nenin 22 të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Ndërsa sa i përket pyetjes se a është Ligji për Përdorimin e Gjuhëve në përputhje me standardet ndërkombëtare, unë do të thosha se Ligji është në masë të madhe në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe do të përpiqem të njëjtën ta argumentoj.

Kështu për shembull, Karta në (nenin 8) të saj parashikon obligim për shtetet-palë që të sigurojnë arsim fillor, të mesëm dhe të lartë në gjuhën e komunitetit. Të njëjtën gjë e kërkon edhe ligji në fjalë.

Tjetër, Karta parashikon detyrimin e shteteve-palë që gjykatat të sigurojnë, me kërkesë të vetëm njëres prej palëve, që procedurat gjyqësore për çështjet penale, civile dhe administrative të zhvillohen në gjuhët rajonale ose të pakicave (neni 9). Të njëjtën gjë e parashikon edhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (si në nenin 2, 6 ashtu edhe në nenin 9).

Po ashtu, Karta përcakton që, sa u përket organeve shtetërore, organeve lokale dhe rajonale, organet me autorizime publike (në pronësi publike dhe private, për aq kohë sa mbeten nën kontrollin publik, si zyrat postare, spitalet, shërbimet e transportit, shërbimet komunale, etj.) ekziston detyrim për shtetet-palë të sigurojnë që këto organe, organizata, institucione, kompani, agjenci (pavarësisht nga emërtimi), të përdorin gjuhën e bashkësisë (që do të thotë vetë institucioni, në funksionimin e tij, të përdor gjuhën e bashkësisë); punonjësit në kontakt me anëtarët e komunitetit të përdorin gjuhën e komunitetit; të sigurohet që anëtarët e bashkësisë të mund të paraqesin shkresat dhe përgjigjet e tyre t'i dorëzojnë gjegjësisht t'i pranojnë në gjuhën e tyre; të lejohen institucionet të hartojnë dokumente në gjuhën e bashkësisë etj. (neni 10). Edhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve parashikon të njëjtën gjë (në nenin 1, 2 etj.).

Sa i përket jetës ekonomike, Karta parashikon obligim për shtetet-palë të sigurojnë që: kontratat e punës, udhëzimet për përdorimin e prodhimeve ose të pajisjeve, fletëpagesat apo urdhërpagesat, çeqet, kambialet etj. të jenë në gjuhët rajonale apo të bashkësisë (neni 13). Të njëjtën gjë e parasheh edhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve deri diku (në nenin 8).

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve njëjtë është edhe në frymën e Konventës Kuadër si instrument tjetër ndërkombëtar më i përgjithshëm në raport me Kartën sa i përket përdorimit të gjuhës (së pakicave). Kështu për shembull, Konventa Kuadër i detyron shtetet-palë që të sigurojnë... përdorimin e gjuhës së pakicës ndërmjet këtyre personave dhe organeve (autoriteteve) administrative (neni 10). Të njëjtën gjë e parasheh edhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (si në nenin 2 ashtu edhe në neni 6 por në mënyrë më të zgjeruar).

Sa i përket sferës së arsimit, Konventa Kuadër përcakton detyrim për shtetet-palë... që në kuadrin e sistemeve të tyre arsimore të sigurojnë që personat që u përkasin pakicave të kenë mundësi për ta mësuar gjuhën e tyre apo për të marrë mësim në atë gjuhë (neni 14). Edhe ligji në fjalë parasheh të njëjtën gjë.

Siç mund ta shohim, dispozitat e Kartës dhe Konventës të përmendura më lart janë në pjesën më të madhe të parapara edhe në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, por siç e përmendëm këto instrumente ndërkombëtare krijojnë vetëm standarde minimale, andaj asgjë nuk e pengon Republikën e Maqedonisë së Veriut që të shkojë mbi këto standarde në drejtim të përmirësimit të përdorimit të gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në RMV.

Dhe deri këtu mund të konstatojmë se, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve përveç që është në përputhje të plotë me Kushtetutën e RMV-së ai është edhe në përputhje dhe mbi këto standarde ndërkombëtare dhe kjo është në rregull për një shtet dhe shoqëri demokratike siç pretendojmë të jemi ne.

### **Barazim apo avancim i gjuhës shqipe sipas ligjit për përdorimin e gjuhëve**

Se kush janë gjuhët zyrtare të shteteve dhe çfarë statusi kanë ato zakonisht përcaktohen në Kushtetutat e tyre (shteteve). Të njëjtën gjë e parashikon edhe Kushtetuta e RMV-së e cila përmban një dispozitë të këtillë (neni 7).

Tani sipas kësaj logjike pikërisht Kushtetuta është akti i cili përcakton barazinë apo pabarazinë gjuhësore. Dhe sipas Kushtetutës së RMV-së është fakt se gjuhë zyrtare në RMV janë: gjuha maqedonase dhe gjuha shqipe (si gjuhë që e flasin së paku 20 % e qytetarëve në RMV), por po ashtu është fakt se sipas përkufizimit aktual të (nenit 7) të Kushtetutës së RMV-së, gjuha shqipe nuk është e barabartë me gjuhën maqedonase sa i përket nivelit të aplikimit. Kjo nga shkakun se gjuha maqedonase është gjuhë e vetme zyrtare në përdorim të përgjithshëm ndërsa gjuha shqipe është gjuhë zyrtare por me specifikime të caktuara.

Në përputhje me këtë që thamë, mund të konstatojmë se, përderisa Kushtetuta përcakton statusin zyrtarë të gjuhëve të një shteti në njërin anë, atëherë në anën tjetër Ligji është akti i cili përcakton fushat apo sferat e përdorimit të gjuhëve zyrtare të shtetit brenda kornizave që ka paraparë kushtetuta dhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve bën pikërisht këtë.

Në rastin konkret dhe në lidhje me pyetjen duhet cekur se Ligji për Përdorimin e Gjuhëve nuk e barazon gjuhën shqipe me gjuhën maqedonase por vetëm e avancon atë, duke shtrirë mundësinë e zbatimit të saj vetëm brenda atyre fushave që parashihen me këtë ligj dhe jo edhe jashtë atyre fushave. Dhe kjo është normale dhe e logjikshme, sepse në drejtësi ekziston një -parim i njohur juridik- që duhet respektuar e që është “Kushtetutshmëria e ligjeve” që nënkupton se të gjitha ligjet duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën. Ligji për Përdorimin e Gjuhëve e bënë një gjë të tillë, pikërisht nëpërmjet asaj që nuk e barazon gjuhën shqipe me gjuhën maqedonase. Sepse po të ndodhte e kundërta, pra po të barazohej gjuha shqipe me gjuhën maqedonase me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve atëherë do të kishim

shkelje të nenit 7, parag. 1 të Kushtetutës (sepse në këtë dispozitë Kushtetutdhënësi nuk ka paraparë barazi të plotë midis gjuhëve zyrtare në nivel kombëtar por ka ruajtur një status preferencial për gjuhën maqedonase) dhe sipas rregullit po të vërtetohet një gjë e tillë atëherë Gjykata Kushtetuese do ta shfuqizonte ligjin në fjalë.

Tani do të mundohem që me disa argumente të mbështetura në dispozitat e ligjit ta vërtetoj se si Ligji për Përdorimin e Gjuhëve nuk e barazon gjuhën shqipe me gjuhën maqedonase, por vetëm e avanco, ndërsa për avancimin e saj do të flasim më poshtë. Barazimi i gjuhës shqipe me gjuhën maqedonase do të duhej të ndodhte që në Kushtetutë që kjo mëtej të nënkuptohej se, gjuha shqipe do të përdoret në mënyrë paralele dhe ex officio me gjuhën maqedonase: në të gjitha institucionet e RMV-së (qofshin shtetërore, administrative, lokale), procedurat, aktet, dokumentet, mbishkrimet e institucioneve, objektet infrastrukturore, monedha, uniforma etj... por pa asnjë kushtëzim, siç është rasti me përdorimin e gjuhëve në Kosovë, Zvicër, Kanada, Belgjikë etj. ku gjuhët zyrtare të parapara me Kushtetutat dhe ligjet e këtyre vendeve përdoren në mënyrë të barabartë paralelisht, sipas detyrës zyrtare dhe pa kushtëzime.

Por në të vërtetë me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve nuk ndodh një gjë e tillë, sepse (1) te ligji për përdorimin e gjuhëve kemi përshkrimin apo bartjen e dispozitave të njëjta (fjala është për nenin 1, parag., 1, 2 dhe 4 të ligjit) nga Kushtetuta më konkretisht (nga nenin 7, parag. 1 dhe 2 i saj). Dhe nëse thirrëmi në këtë, a kjo është e patjetërsueshme për t'u thirrur, do të vijmë deri te konstatimi tashmë shumë herë i përsëritur e i elaboruar më lart, se Kushtetuta e RMV-së nuk parasheh status të barabartë të përdorimit të gjuhës shqipe me gjuhën maqedonase dhe në pajtim me këtë as ligji për përdorimin e gjuhëve nuk e barazon gjuhën shqipe me atë maqedonase<sup>6</sup>; (2) gjuha shqipe sipas këtij ligji mund të themi që përdoret "pjesërisht" në mënyrë të barabartë me gjuhën maqedonase në institucionet si në Kuvendin

<sup>6</sup> Neni 1 dhe 2 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve është i njëjtë me Nenin 7, parag. 1 dhe 2 të Kushtetutës së RM-së dhe lexon si vijon: 1) "Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik; 2) Gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e shtetasve (gjuha shqipe), gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe shkrimi i saj, në pajtim me këtë ligj".

A për të qenë e barabartë gjuha shqipe me gjuhën maqedonase në RMV, duhej të ndiqej shembulli më i afërt dhe më i qartë i Ligjit për përdorimin e gjuhëve i Kosovës (por kjo kur do të jetë e mundur për t'u ndryshuar Kushtetua e RMV-së) i cili lexon si vijon: Neni 2 (1) "Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës; dhe (2) Të gjithë personat kanë të drejta të barabarta në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet e Kosovës".

Dhe ja ky është edhe si një shembull eklatant për të bërë të qartë se si gjuha shqipe sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve nuk po barazohet me gjuhën maqedonase por vetëm po avancohet.

e RMV-së<sup>7</sup>, Qeverinë e RMV-së<sup>8</sup> dhe në mbledhjet e Komisionit Shtetëror Zgjedhor<sup>9</sup>, pastaj në Ueb faqet dhe përmbajtjet e tyre<sup>10</sup>, në Jetën ekonomike<sup>11</sup>, në dokumentet personale dhe të udhëtimit<sup>12</sup> si dhe në botimin e ligjeve, akteve nën ligjore, vendimeve dhe shpalljeve të institucioneve nga neni 1, 2 (3) në “Gazetën zyrtare” të RMV-së<sup>13</sup>.

Por, poashtu sipas këtij ligji, 3) gjuha shqipe nuk përdoret në mënyrë të barabartë (paralelisht dhe ex officio) në asnjë vend tjetër me gjuhën maqedonase apo edhe nëse do të përdoret ajo kushtëzohet (se do të përdoret) nëse plotësohet kushti p.sh.: a) nëse në njësinë e vetëqeverisjes lokale jetojnë “20 % e qytetarëve”, atëherë do të përdoret edhe gjuha shqipe dhe alfabeti i saj si gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase<sup>14</sup> por nëse nuk jetojnë (20 %) në një komunë, por më pak (p.sh. 19 apo 15 etj.) atëherë gjuha shqipe nuk do të jetë zyrtare, sepse nuk plotësohet kushti dhe shembuj të tjerë si; b) gjuha shqipe do të jetë gjuhë zyrtare në komunikim, përdorim dhe zbatim në të gjitha procedurat e qytetarëve para të gjitha institucioneve të pushtetit shtetëror,<sup>15</sup> por, poashtu këtu është e paqartë edhe (nëse vetë institucionet shtetërore gjatë funksionimit të tyre a do ta përdorin gjuhën shqipe apo jo); c) funksionarë të zgjedhur ose të emëruar të institucioneve nga neni 1 dhe 2 parag. 3 në komunikimin e tyre zyrtar do të mund ta përdorin gjuhën shqipe dhe alfabetin e saj krahas gjuhës maqedonase vetëm nëse së paku njëri prej tyre (funksionarëve) e flet gjuhën shqipe<sup>16</sup>; ç) institucionet nga neni 1 dhe 2 parag. 3 si dhe të gjitha institucionet tjera janë të obliguara me detyrë zyrtare (ex officio) të sigurojnë që përdorimi, komunikimi dhe procedurat të zhvillohen në gjuhën shqipe; të gjitha vendimet, aktet e tjera dhe legjitimacionet që dalin nga kompetenca e këtyre institucioneve që i cekëm më lart të jenë edhe në gjuhën shqipe krahas asaj maqedonase; personi i zgjedhur ose i emëruar emrin personal në vendimet dhe aktet tjera në kuadër të kompetencave të institucioneve të lartpërmendura do të mund ta shkruajë, nëse pala apo pjesëmarrësi është shqiptar përkatësisht personi flet gjuhën shqipe<sup>17</sup>, në të kundërtën gjuha shqipe nuk do të përdoret ex officio as në institucionet e lartpërmendura nga neni 1,2 (3), as në procedurat pamarrë parasysh kushdo

<sup>7</sup> Shih për më tepër, Nenin 4 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, “Gazeta zyrtare” e RMV-së, nr.7/2019.

<sup>8</sup> Po aty, Neni 5 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

<sup>9</sup> Po aty, Neni 15 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

<sup>10</sup> Po aty, Neni 6 (4) i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

<sup>11</sup> Po aty, Neni 8 (2) i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

<sup>12</sup> Po aty, Nenin 12 (3) të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

<sup>13</sup> Po aty, Neni 17 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

<sup>14</sup> Po aty, Neni 1 (4).

<sup>15</sup> Po aty, Neni 2 (3).

<sup>16</sup> Po aty, Neni 3.

<sup>17</sup> Shih për më tepër, Neni 6 (1, 2, 3) i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, “Gazeta zyrtare” e RMV-së, nr.7/2019.



qofshin ato e as në dokumente, shkresa, akte etj.; 4) emrat e objekteve infrastrukurore (rrugëve, shesheve, urave) do të shkruhen edhe në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e pranuar përgjithësisht nga bashkësia ndërkombëtare krahas gjuhës maqedonase por vetëm në Shkup dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku së paku 20 % e qytetarëve flasin gjuhë shqipe;<sup>18</sup> 5) Por sipas këtij ligji duhet cekur se gjuha shqipe fare nuk përdoret në: Marrëdhëniet ndërkombëtare,<sup>19</sup> kartëmonedhat, monedhat dhe uniformat e ushtrisë,<sup>20</sup> por edhe në letrat me vlerë (çeku, kambiali) komandat e ushtrisë etj.

### **Analizim dhe sqarim i strukturës së Ligji për Përdorimin e Gjuhëve**

Në këtë pjesë në fillim do të themi disa fjalë hyrëse për Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve pastaj, do të analizojmë dhe sqarojmë strukturën e ligjit në fjalë.

Ligji i ri për Përdorimin e Gjuhëve<sup>21</sup> në fillim u promovua nga partitë politike shqiptare dhe më pas u propozua nga Qeveria e RMV-së<sup>22</sup> me qëllim që të rregullojë në mënyrë më efektive përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Deri te nevoja për rregullimin plotësues të materies juridike me të cilën rregullohet përdorimi i gjuhëve kanë çuar parregullsitë e detektuar në zbatimin dhe përfshirjen e rregullativës ekzistuese juridike.

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve herën e parë në procedurë parlamentare u miratua nga shumica me 69 vota pro më datë 11.1.2018, por i njëjti nuk hyri në fuqi, kjo nga shkak se Presidenti i RMV-së refuzoi që ta dekretojë të njëjtin për arsye të pabaza dhe sipas rregullit, në raste të këtilla ligji kthehet përsëri në procedurë parlamentare siç edhe ndodhi për të kaluar në leximin e tretë të tij. Mirëpo në këtë kohë me të kthyer ligjin përsëri në procedurë parlamentare, partia më e madhe opozitare VMRO-DPMNE, dorëzon në Parlament mbi 35.000 amendamente për këtë ligj dhe po qe se shihen mirë këto amendamente, qëllimi i tyre nuk është aspak për ta përmirësuar ligjin, por vetëm sa për ta bllokuar të njëjtin. Sidoqoftë me miratimin e këtij ligji që është i patjetërsueshëm për t'u miratuar, ligji i vitit 2008 do të zëvendësohet dhe zbatimi i tij do të ndërpritet. Dhe miratimi i këtij ligji ndodhi përsëri më 14.03.2018, ndërsa është publikuar në Gazetën Zyrtare më 14.01.2019 dhe kështu ka hyrë në fuqi nga kjo ditë.

<sup>18</sup>Po aty, Neni 16 (1).

<sup>19</sup>Po aty, Neni 1 (2).

<sup>20</sup>Po aty, Neni 8 (1 dhe 3).

<sup>21</sup>Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, "Gazeta zyrtare" e RMV-së, nr.7/2019.

<sup>22</sup>Qeveria në seancën e 16-të të mbajtur më 25.7.2017 miratoi programin nacional për miratimin e të drejtës së BE-së 2017-2019, me të cilin janë përcaktuar të gjitha masat të cilat Qeveria i planifikon për realizim në këtë vit dhe në 2 vitet e ardhshme, në kuadër të të cilave është paraparë edhe miratimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve dhe duke pasur parasysh se bëhet fjalë për propozim-ligj i cili është pjesë e procesit të integritit evropian, Qeveria propozon që i njëjti të procesuhet në pajtim me kapitullin 10-a dhe me EPP numër 2017.0000.7414.

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve përbëhet nga 25 nene në të cilat janë të inkorporuara edhe amendamentet kushtetuese që kanë të bëjnë me përdorimin dhe zbatimin e gjuhës të cilën e flasin së paku 20 % e qytetarëve të RMV-së.

Me këtë ligj paralelisht rregullohen parimet, mënyra dhe përgjegjësia e institucioneve që të mundësojnë përdorimin zyrtar të gjuhës të cilën e flasin së paku 20 % e qytetarëve (gjuhën shqipe) dhe alfabetin e saj vis a vis të mundësojnë të drejtën e qytetarëve për ta përdorur dhe zbatuar atë gjuhë në procedura zyrtare.

Ligji i ri për Përdorimin e Gjuhëve duhet thënë se e ndryshon qasjen për përdorimin e gjuhës shqipe në krahasim me ligjin e vjetër. Kjo për faktin se, ligji për përdorimin e gjuhës shqipe i vitit 2008<sup>23</sup> e përcaktonte gjuhën shqipe si një të drejtë individuale për personat që ta përdorin atë (gjuhën shqipe) në institucione të caktuara ose në komunikim me institucionet, por nuk e bënte gjuhën shqipe zyrtare nëpër institucione. Me një fjalë, ligji i 2008-ës për përdorimin e gjuhës shqipe e përcaktonte gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare vetëm në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku të paktën 20 % e qytetarëve janë shqiptarë. Poashtu, ky ligj (i 2008-ës) përmban formulime të paqarta, konfuze, të komplikuar dhe absurde, sepse kur përdoret gjuha shqipe specifikon në ç'mënyrë përdoret dhe në të njëjtën kohë kufizon përdorimin e saj jashtë kornizës që krijon. Ndryshe thënë, ligji ka dy anët, nga njëra anë lejon përdorimin e gjuhës shqipe, por në të njëjtën kohë kufizon përdorimin e saj jashtë fushëveprimit të saj. Për shembull, meqenëse ligji nuk parashikon përdorimin e gjuhës shqipe në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministrat që flasin shqip nuk kanë të drejtë të flasin në seancat e qeverisë ose në trupat e tyre në gjuhën shqipe. Pra, ligji në të vërtetë kufizon të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe në këtë rast specifik.

Dhe ndryshimi i qasjes nga ligji i ri për përdorimin e gjuhëve bëhet pikërisht këtu, se gjuha shqipe përveç si një (a) e drejtë individuale me këtë ligj përcaktohet dhe sigurohet që do të jetë një gjuhë zyrtare edhe në (b) institucionet shtetërore. Për ta thjeshtësuar, sipas frymës së Marrëveshjes së Ohrit, ligji për përdorimin e gjuhëve parasheh apo bën një kombinim (1) të së drejtës individuale të cilën e parasheh për shfrytëzuesit (konsumatorët) si p.sh. në Veles, Kriva Pallankë, Strumicë...etj. (shqiptarët të mund të komunikojnë dhe njëkohësisht t'u komunikohet në gjuhën shqipe edhe në qytetet apo vendbanimet ku ato nuk janë shumicë); (2) parasheh përdorim, shfrytëzim dhe zbatim zyrtar të gjuhës shqipe (të gjuhës së komunitetit të cilin MKO-ja e njeh si komunitet të barabartë me komunitetin maqedonas) duke e zgjeruar përdorimin e saj në mënyrë vertikale në institucionet qendrore nga institucionet lokale që ishte me ligjin 2008. Pra, siç thash me këtë ligj, përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe bëhet duke u zgjeruar vertikalisht e jo duke u

---

<sup>23</sup> Në fakt emërtimi i saktë i këtij ligji është: "Ligji për përdorimin e gjuhës të cilën e flasin 20 % e qytetarëve në RM dhe në njësitë e vetadministrimit lokal".

shtrirë horizontalisht apo territorialisht siç është gjuha maqedonase (zyrtare në tërë territorin dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare të RMV-së) ky është dallimi. Gjuha shqipe sipas këtij ligji do të përdoret, shfrytëzohet dhe zbatohet nga shqiptarët 1) në çdo vend brenda RMV-së ku ato do të kenë nevojë për përdorim zyrtar të saj<sup>24</sup> si dhe do të përdoret, shfrytëzohet dhe zbatohet 2) dhe nga të gjitha institucionet shtetërore dhe 3) përpara cilëso qoftë procedurë të parapara me këtë ligj.<sup>25</sup>

Mirëpo, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve për dallim nga ligji i vitit 2008 ka më pak dispozita, pastaj nuk ka ndarje të qartë të strukturës së përbajtjes si dhe duket më i përgjithshëm duke mos dhënë sqarimet e duhura për përdorimin e gjuhëve në fushat e cekura. Tani këtu unë shoh dy anë: anën pozitive që nënkupton, kur ju shkruani më shkurt, më qartë dhe në mënyrë më të përmbledhur ju lejoni hapësirë më të gjerë veprimi dhe zbatimi të një të drejte (në rastin konkret të përdorimit të gjuhëve) dhe e kundërta apo ana negative sa më shumë që shkruani dhe mundoheni që të zgjeroheni aq më tepër ju e kufizoni përdorimin e një të drejte.

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve është i strukturuar në këtë formë dhe me të rregullohen: (1) Dispozitat e përgjithshme (neni 1-3) që flasin për gjuhët zyrtare që janë: gjuha maqedonase dhe alfabeti cirilik si dhe gjuha të cilën e flasin 20 % e qytetarëve (gjuha shqipe) dhe alfabeti i saj; (2) E drejta e qytetarëve për ta përdor cilëndo nga gjuhët zyrtare (gjuhën maqedonase dhe/ose shqipe) dhe alfabetet e tyre në njërin anë dhe në anën tjetër obligimi i institucioneve shtetërore (Kuvendi i RMV-së, Qeveria e RMV-së, Presidenti i RMV-së, Gjyqësia, Prokuroria Publike, Gjykata Kushtetuese e RMV-së, Avokati i Popullit i RMV-së; në procesin zgjedhor, arsim, shkencë, kulturë, shëndetësi, gjatë zbatimit autorizimeve policore, në veprimtarinë radiodifuzive, noteri, përmbarrim, objekte infrastrukturore, evidencën e amzës, dokumentet personale, financat, ekonomi, si dhe sfera të tjera) dhe institucioneve të tjera si (ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, entet dhe organizatat, komisionet, personat juridik që kryejnë autorizime publike etj.) që t'u mundësojnë qytetarëve shfrytëzimin, përdorimin dhe zbatimin e atyre gjuhëve zyrtare dhe alfabetet e tyre në cilët do qoftë procedurë (gjyqësore, administrative, ekzekutive, parahetimore dhe hetimore, penale dhe për kundërvajtje, kontestimore dhe jashtëkontestimore, për ekzekutimin e sanksioneve si dhe procedura të tjera) si dhe zbatimin e atyre procedurave në atë gjuhë zyrtare dhe atë alfabet (neni 2); (3) E drejta e funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar të institucioneve të lartpërmendura (selia e të cilëve ndodhet në Shkup ose në ndonjë komunë në të cilën së paku 20 % e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase) për ta përdor në

<sup>24</sup> Pra, këtu shqiptarët do të mund ta përdorin gjuhën shqipe si të drejtë individuale kur do të jenë si shfrytëzues.

<sup>25</sup>Shih: Neni 2.

komunikim zyrtar gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj si dhe gjuhën shqipe nëse njëri prej funksionarëve të zgjedhur ose emëruar flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase (neni 3); (4) Përdorimi i gjuhës në Kuvend (neni 4); (5) Përdorimi i gjuhës në Qeveri (neni 5); (6) Materia për përdorimin e gjuhëve në institucionet nga neni 1 parag. 3 dhe neni 2 parag. 3 i këtij ligji (neni 6); (7) Materia e gjuhës për shkrimin e mbishkrimeve të institucioneve nga neni 1 parag. 3 dhe neni 2 parag. 3 (neni 7); (8) Materia e gjuhës për kartëmonedhat dhe monedhat, për pullat postare, fletëpagesat, raportet fiskale, faturat, banderolat pastaj uniformat e policisë, zjarrfikësve, shëndetësisë (neni 8); (9) Përdorimi i gjuhës në Procedurat gjyqësore, administrative, ekzekutive, parahetimore dhe hetimore, penale dhe për kundërvajtje, kontestimore dhe jashtëkontestimore, për ekzekutimin e sanksioneve si dhe procedura të tjera para gjykatave dhe prokurorive publike (neni 9); (10) Përdorimi i gjuhëve në Procedurat noteriale dhe përmbaruese (neni 10); (11) Materia e përdorimit të gjuhëve në fushën e ekzekutimit të sanksioneve (neni 11); (12) Mbajtja e Evidencës së amzës, botimi i aktvendimeve, certifikatave, vërtetimeve dhe akteve tjera si dhe lëshimi i dokumenteve personale dhe dokumenteve të udhëtimit (neni 12); (13) Materia për gjuhën dhe alfabetin për shtypjen e formularit për letërnjoftim (neni 13); (14) Materia për gjuhën dhe alfabetin për shtypjen e formularit për pasaportë dhe fletudhëtim (neni 14); (15) Përdorimi i gjuhëve në seancat e Komisionit Shtetëror Zgjedhor dhe të komisioneve komunale (neni 15); (16) Përdorimi i gjuhëve në objektet e infrastrukturës, vendkalimet kufitare dhe aeroportet (neni 16); (17) Përdorimi i gjuhëve në botimin e akteve ligjore, nënligjore dhe shpalljeve të institucioneve nga neni 1 (3) dhe neni 2 (3) në Gazetën Zyrtare të RM-së (neni 17); (18) Puna dhe kompetencat e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës (neni 18 dhe 19); (19) Parashihet edhe themelimi i Inspektoriatit për Përdorimin e Gjuhëve (neni 20); (20) Parashihet miratimi i masave për promovimin e zbatimit të gjuhëve zyrtare dhe garantimin e mbrojtjes së gjuhëve të komuniteteve pakicë gjuha amë e të cilëve nuk është zyrtare nga ana e Qeverisë së RM-së dhe e të gjitha institucioneve kompetente për zbatimin e dispozitave të këtij ligji (neni 21); (21) Parashihet përgjegjësia kundërvajtëse dhe gjobat përkatëse për mosrespektimin e dispozitave të këtij ligji (neni 22); (22) Përcaktohen afatet për obligimet e më shumë subjekteve të cilat ata duhet t'i ndërmarrin për implementimin e ligjit (neni 23); (23) Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare (neni 24 dhe 25).

## Conclusions

1. Constitution of the RNM, as it does not affect it, but rather behaves within its framework, in terms of the use of languages.

2. In addition, the Law on the Use of Languages is also in accordance and in the spirit of international standards, with particular emphasis on the European

Charter for Regional or Minority Languages as well as the Framework Convention for the Protection of National Minorities or in other words as the basic resources for the drafting of this law have been precisely these international instruments one as a separate instrument and the other as a more general one.

3. The Law on the Use of Languages does not equate the Albanian language with the Macedonian language, because the Albanian language according to this law is not used in parallel, *ex officio* and unconditionally with the Macedonian language, which otherwise is why we could say that it equates it. But according to this law we can say that the Albanian language is used only “partially” on an equal basis with the Macedonian language in institutions such as the Assembly of the Republic of Macedonia, the Government of the Republic of Macedonia and in the meetings of the State Election Commission, then in their websites and contents, in their economic life, personal and travel documents, as well as in the publication of laws, sub-legal acts, decisions and proclamations of institutions from Article 1, 2 (3) in the “Official Gazette” of the Republic of Macedonia.

4. The Law on the Use of Languages only advances the Albanian language, extending the possibility of its implementation only within those areas that are foreseen by this Law and not even outside those areas. So, according to this law, Albanians will be able to use, use and apply the Albanian language 1) in any country within the Republic of Macedonia where they will need official use of it as well as it will be used, used and implemented 2) in all state institutions and 3) before any procedure provided by this law.

But according to this law, it should be noted that the Albanian language is not used at all in: International relations, banknotes, coins and uniforms of the army, but also in securities (cheque, bills of exchange) army commands etc.

5. The new Law on the Use of Languages has a special weight that changes the approach to the use of the Albanian language compared to the old law. This is due to the fact that the Law on the Use of the Albanian Language of 2008 defined the Albanian language as an individual right for persons to use it (Albanian language) in certain institutions or in communication with institutions but did not make the Albanian language official in institutions, while the change of approach from the new Law on the Use of Languages is done here, that the Albanian language except as a (a) an individual right that is foreseen for users (consumers), this law defines and ensures that it will be an official language in (b) state institutions, in a word this law extends its use (Albanian language) vertically to central institutions, and not by extending horizontally or territorial as the Macedonian language (official in the whole territory and international relations of RNM), so this is also the difference. This fact, the adoption of the new law, at the same time proves that the Albanian language has had the space and the need to advance in relation to the demands of Albanians.

6. The Law on the Use of Languages, unlike the Law of 2008, has fewer provisions (25), then there is no clear division of the content structure, there is no clear and clean division of state power bodies and it seems more general by not giving proper explanations for the use of languages in the above-mentioned areas, which leaves its implementation in certain areas unclear, as well as unclear, confusing and inaccurate provisions. Due to these shortcomings conditionally stated, the problem will be its implementation, because a large part of the fields only mentions it as such and leaves it with so much and does not contain concrete provisions on how the same will be applied, for example, in the sphere of education (will the general provisions of this law also apply to this sphere or will the provisions of the law on local self-government apply, for example, how pedagogical records will be kept in schools, where Albanians are not a majority but there are Albanian classes in Albanian language?). Or in the sphere of health, where the implementation of the same will be an even bigger problem, since it does not contain a specific provision with which to regulate this sphere, such as how to act in relations, a Macedonian specialist doctor and an Albanian patient, how the conversation will take place between them, when we know that intimacy is expressed in this sphere, e.g. (to the gynecologist), or in which language the reports of the specialist will be given to ascertain the specific condition of the Albanian patient. To be more precise, which dispositions will apply in such cases? This is also a problem in other areas.

**Recensentë:**

**Prof. Dr. Mersim Maksuti**

**Prof. Dr. Bujar Ahmedi**

**Literatura:**

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Ligji për përdorimin e gjuhës të cilën e flasin 20% e qytetarëve në RM dhe në njësitë e vetadministrimit lokal, “Gazeta zyrtare” e RM-së, 101/08;
- Kodi zgjedhor i RMV-së, “Gazeta zyrtare” e RM-së, Nr. 40/06;
- Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve;
- Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, “Gazeta zyrtare” e RM-së, nr.7/2019;
- Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, “Gazeta Zyrtare” e R. së Kosovës, nr. 10/07 prej 01.03.2007.